

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ-36/11

Data: 05 korrik 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar i kolegjit, gjyqtarët e EULEX-it Gerrit Marc-Sprenger dhe Charles L Smith III dhe gjyqtarëve të Kosovës të Gjykatës Supreme të Kosovës, Emine Kaciku dhe Valdete Daka si anëtare të kolegjit, në praninë e Këshilltarit Ligjor të EULEX-it Adnan Isufi, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit, në lëndën penale P nr. 203/2005 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kundër të pandehurit:

Sh M , i lindur më , në fshatin , emri i të atit emri i nënës , nga gjinia , Shqiptar i Kosovës, , me vendbanim të mëhershëm në rrugën në .

I akuzuar për veprat penale Vrasje e Rëndë dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë nga neni 30 paragrafi 2, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Penal të Kosovës (tash e tutje 'LPK') në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje 'KP i RSFJ'), Posedim i paautorizuar i Armëve nga neni 8.2 dhe 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2001 / 7 në lidhje me nenin 22 të KP RSFJ-së dhe Posedim i paligjshëm i armëve nga 328 paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tash e tutje 'KPPK'¹).


Duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi Av Teki BOKSHI në emër të pandehurit Sh M , kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P nr. 2003/2005 të datës 09 nëntor 2005, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap 190/2009, të datës 27 janar 2010 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, API 01/2010 të datës 26 nëntor 2010,

Në pajtim me nenin 454 paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje "KPPPK"²), pas seancës të këshillimit dhe votimit të mbajtur më 05 korrik 2011, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e datës 21 shkurt 2011, e paraqitur nga mbrojtësi Av Teki BOKSHI në emër të pandehurit Sh M , kundër aktgjykimit të Gjykatës së

¹ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka hyr në fuqi në prill 2004, i cili më vonë u ndryshua.
² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale ka hyr në fuqi në prill 2004, i cili u ndryshua më vonë.



Qarkut të Prishtinës P nr. 2003/2005 i datës 09 nëntor 2005, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap 190/2009, i datës 27 janar 2010 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, API 01/2010 i datës 26 nëntor 2010, refuzohet si e pabazuar dhe konfirmohet aktgjykimit i Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 456 të KPPPK.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës


Më 23 mars 2004 rreth orës 21:45, një njësi e policisë e përbërë nga një ekip i përzier prej tre policësh, ndërkombëtar dhe vendor, si edhe përkthyesi ishin cak i sulmit në rrugën publike afër fshatit Sh të P . Dy personat zyrtar, një polic ndërkombëtar K E (Polic i UNMIK-ut) dhe një polic vendor A Rr ishin qëlluar për vdekje në vend të ngjarjes. Përkthyesi R Z ishte qëlluar me një plumb në shpatullën e majtë dhe copëza metalike kishin goditur kokën e tij. Megjithatë R Z ka shpëtuar. Anëtari tjetër i ekipit, polici B M fatmirësisht i shpëtoi pa lëndime një pusie të rrezikshme për jetën e tij.

Gjatë sulmit polici B M hapi derën e pasme të anës së djathtë duke kërcyer jashtë automobilin. Në këtë moment B M fillo të gjuaj në drejtim të sulmuesve. Dy (2) gjuajtjet e tij - ai ka shkrepur dhjetë (10) të shtëna – qëlluan sulmuesin A S i cili vdiq më vonë.

Hetimet u iniciuan dhe u kryen nga Zyra e Prokurorisë Publike Ndërkombëtare kundër disa individëve.

Më 07 prill 2005 pas përfundimit të hetimeve, aktakuza ishte ngritur kundër njëmbëdhjetë (11) të akuzuarve. Që nga atëherë janë bërë disa ndryshime në aktakuzë.

Më 09 nëntor 2007 Gjykata e Qarkut të Prishtinës shpalli fajtor të pandehurin Sh M për kryerjen e veprave penale Vrasje e Rëndë dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë nga neni 30 paragrafi 2, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Penal të Kosovës (tash e tutje 'LPK') në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje 'KP i RSFJ'), Posedim i paautorizuar i armëve nga neni 8.2 dhe 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2001 / 7 në lidhje me nenin 22 të KP RSFJ-së dhe Posedim i paligjshëm i armëve nga 328 paragrafi 2 i KPPK. Në bazë të nenit 48 të KP të RSFJ-së gjykata i shqiptoi të akuzuarit një dënim unik në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) vjet burgim, në të cilën është llogaritur koha që kaloi në paraburgim që nga 7 prill 2004.



Më 27 janar 2010 Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi ankesat e të pandehurit Sh. M dhe hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e paraqitur nga babai i tij G M përderisa vërtetoi pjesërisht ankesat e mbrojtjes të pandehurit, Av. Teki Bokshi dhe Av. Metush Sadiku duke modifikuar aktgjykimin e ankimuar vetëm në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale. Të pandehurit megjithatë i ishte shqiptuar përsëri një dënim unik prej tridhjetë (30) vjet burgim.

Me aktgjykimin API nr. 1/2010 të datës 26 nëntor 2010 Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi ankesën e avokatit mbrojtës të pandehurit dhe hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e paraqitur nga i ati i të pandehurit G M . Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i kundërshtuar nga avokati mbrojtës në shkallën e tretë u vërtetua.

Mbrojtja në emër të pandehurit, av. Teki Bokshi paraqiti një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimin të formës së prerë P nr. 203/2005 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 09 nëntor 2007, kundër aktgjykimin Ap nr. 190/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27 janar 2010 dhe kundër aktgjykimin API nr. 1/2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 26 nëntor 2010.

Avokati mbrojtës kërkoi ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara; lirim të pandehurit nga të gjitha akuzat penale apo për të kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.


Lënda u dërgua në ZPShK për marrje të një mendimi.

Me parashtrësën KMLP. II. Nr. 38/11, të datës 28 prill 2011 Zyra e Prokurorit të Shtetit paraqiti një përgjigje dhe propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjatë vlerësimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi me sa vijon:

- a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur në gjykatën kompetente sipas nenit 454 par 1 dhe brenda afatit në pajtim me nenin 452 par 3 i KPPPK.
- b. Gjykata Supreme vendosi në një seancë sikurse përshkruhet me nenin 454 paragrafi 1 i KPPPK. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk kërkohet.
- c. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.



Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon shkelje të Ligjit Penal, shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Penale dhe vendimit për sanksionet penale.

Avokati mbrojtës pretendon një numër të shkeljeve disa prej të cilave po ashtu janë ngritur dhe parashtruar gjatë rrjedhës së procedurës në shkallë të dytë dhe të tretë. Mbrojtja pohon se këto pretendime të ngritura në shkallët e mëparshme duhet të konsiderohen nga gjykata si pjesë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Qysh në fillim Gjykata Supreme e Kosovës vë në dukje se pjesët e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe të ankesave të mëhershme të cilat mbrojtja i parashtron për tu shqyrtuar si pjesë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kryesisht i referohen gjendjes faktike. Gjykata Supreme e Kosovës, megjithatë është e kufizuar në vlerësimin e saj nga neni 451 dhe neni 455 të KPPPK. Avokati mbrojtës nuk mund të paraqes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbi bazat e një vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike. Rrjedhimisht kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të të dhënave të lëndës, konstaton se aktgjykimet e ankimuar të lëshuara në shkallë të mëparshme nuk lejojnë *ex officio* një ndërhyrje. Prandaj, në pajtim me nenin 455 të KPPPK, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizojë veten në shqyrtimin e këtyre shkeljeve të ligjit të cilat i pretendon pala kërkuese në kërkesën e tij.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë avokati mbrojtës pretendon me sa vijon:


A. SHKELJE ESENCIALE TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE DHE SHKELJE TË TIJERA TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE

1. Avokati mbrojtës pretendon shkelje të procedurës nga gjykata në shkallët e mëparshme kur e ka vendosur si të papranueshme ankesën e paraqitur nga i ati i të pandehurit. Mbrojtja pretendon se krimi i supozuar ka ndodhur para hyrjes në fuqi të Kodit aktual të Procedurës dhe në pajtim me Ligjin e Procedurës Penale të ish-RSFJ ankesa e paraqitur nga i ati i të pandehurit është e pranueshme. Prandaj pasi që këto ankesa të paraqitura nga i ati i të pandehurit Sh M nuk janë marrë parasysh, mbrojtja kërkon të rishqyrtohen dhe konsiderohen këto ankesa si pjesë integrale e kërkesës të avokatit mbrojtës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në përgjigjen e kësaj pyetjeje, është e rëndësishme të theksohet se ligji procedural në fuqi në këtë çështje penale është KPPPK. Nuk ka kontestime për zbatimin e ligjit të procedurës madje edhe nga avokati mbrojtës. Neni 399 paragrafi 1 i KPPPK-së thotë:

(1) Ankesë mund të paraqesin palët, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari.

Në lëndën në fjalë, i pandehuri u përfaqësua nga një avokat mbrojtës profesional gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale. Dispozitat e aplikueshme procedurale përcaktojnë personat e




autorizuar të cilët mund të paraqesin ankesë kundër një aktgjykimi të lëshuar në shkallë të parë. Është e qartë se babai i të pandehurit nuk ishte një person i autorizuar për të paraqitur ankesë. Megjithatë nëse i ati i të pandehurit ka dashur të drejtohet gjykatës pa dyshim ai ka pasur mundësi të mjaftueshme për t'i transmetuar me anë të mbrojtësit i cili përfaqëson të pandehurin. Profesionalizmi dhe kompetenca e mbrojtësit që përfaqëson të akuzuarin nuk kanë asnjë dyshim. Prandaj ky kolegji është i mendimit se gjykata e apelit ka vendosur drejt, kur i ka vendosur si të papranueshme ankesat e paraqitura nga i ati i të pandehurit. Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me avokatin mbrojtës që në rast të një ndryshimi në ligjin në fuqi para vendimit përfundimtar në një lëndë të caktuar, do të zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin. Megjithatë ky parim zbatohet për ligjin penal dhe jo për ligjin procedural.

2. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimet e shqyrtuara janë të bazuara në prova indirekte dhe / apo rrethanore në shkelje të dispozitës së nenit 157 të KPPPK. Avokati mbrojtës pohon se gjykata nuk duhet të shpallë të akuzuarin fajtor bazuar vetëm ose në shkallë vendimtare në një provë të vetme siç është në rastin me aktgjykimet e kundërshtuara të cilat kryesisht janë bazuar në përgjime. Pasi që aktgjykimet janë të bazuara vetëm në përgjimet telefonike apo kësaj prove i është dhënë rëndësi vendimtare, gjykata nuk mund të shpall të pandehurin fajtor në bazë të nenit 157 të KPPPK.

Në adresimin e pretendimit të ankuesit, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me mbrojtësin që gjykata nuk duhet të shpall të akuzuarin fajtor duke u bazuar vetëm ose në një masë vendimtare në dëshmi apo prova të tjera të cilat nuk mund të kundërshtohen nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë një faze të procedurës penale. Kolegji megjithatë vëren se gjykata e shkallës së parë nuk është mbështetur vetëm apo në një masë vendimtare mbi provën e cila nuk është kundërshtuar nga avokati mbrojtës gjatë fazës së procedurës penale. Avokati mbrojtës nuk ka treguar në mënyrë specifike provën dhe/ose provat në të cilat Gjykata është mbështetur e për të cilat avokatit mbrojtës eventualisht nuk i ishte dhënë mundësia t'i kundërshtojë. Ky kolegji mendon se pretendimet e parashtruara në përgjithësi janë pa meritë. Është e dukshme se mbrojtësve u janë dhënë mundësi të bollshme për të kundërshtuar provat e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor. Gjykata vëren se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e bën një referim të duhur në provat në të cilat është mbështetur gjykata të cilat janë marrë, administruar dhe vlerësuar si duhet nga gjykata.

3. Avokati mbrojtës pretendon se dispozitivi i aktgjykimeve të kundërshtuara të lëshuara në shkallët e mëparshme është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij ose në kundërshtim me bazat e aktgjykimeve; në veçanti, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimeve është kontradiktor me përmbajtjen e provave materiale dhe dëshmitë në procesverbalin e rishqyrtimit. Kjo, sipas mbrojtjes, përbën shkelje të rënda të dispozitave të procedurës penale përkatësisht, nenit 403, paragrafi 1, pika 12 e KPPPK. Avokati mbrojtës më tej argumenton kontradiktën në mes të aktgjykimit të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë në pjesën që gjykata e shkallës së parë në faqen 36 të aktgjykimit deklaroi se "....trupit gjykoës vëren se nuk



ka provë të vetme të drejtpërdrejtë që Sh M apo F E bëjnë pjesë në grupin e sulmuesve ...”.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se përmbajtja e një aktgjykimi është përcaktuar në nenin 396 të KPPPK. Ky nen përcakton se aktgjykimi duhet të ketë pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin. Secila nga këto pjesë duhet të përmbajë informacion specifik të përshkruar në dispozitat e tjera të cilat gjithashtu përfshijnë arsyetimi në lidhje me dënimin.

Përmbajtja e detyrueshme e dispozitivit është e parashikuar në nenin 396 të KPPPK, në mënyrë specifike, paragrafët (3) dhe (4) ...


(3) *“dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza”*

(4) *“kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale me kërkesën pasurore juridike nëse një kërkesë e tillë është paraqitur”.*

Në rishqyrtimin e kësaj pike, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka mundur të vërtetoj asnjë mangësi substanciale sa i përket dispozitivit të aktgjykimeve të ankimuara. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë lëndë dispozitivi i aktgjykimeve të kundërshtuara është mjaft i qartë. Ata i bëjnë një referencë të duhur dispozitave të ligjit penal, duke qartësuar në këtë mënyrë se çfarë forme e fajësisë është vërtetuar nga gjykata për të pandehurin.

Mbrojtësi i referohet faqes 36 të aktgjykimit në të cilën është thënë se “...trupit gjykues vëren se nuk ka provë të vetme të drejtpërdrejtë që Sh M apo F E bëjnë pjesë në grupin e sulmuesve ...”. Është mendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës se leximi përzgjedhës i aktgjykimit dhe nxjerrja e fjalive nga konteksti i përgjithshëm e bën një argument të pa meritë. Dispozitivi dhe arsyetimi janë pjesë organike dhe të pandashme të një aktgjykimi. Si i tillë aktgjykimi duhet të lexohet në tërë kontekstin e tij. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se të lexuarit në tërësinë e tij nuk ka kundërthënie dhe / ose kontradiktë mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit të atakuar. Prandaj pretendimi i avokatit mbrojtës për kundërthënie të aktgjykimit është i pabazë.

4. Avokati mbrojtës pretendon shkelje të procedurës pasi që gjykata në shkallët e mëparshme ka vendosur gabimisht se i pandehuri Sh M së bashku me persona të tjerë ka shtënë me armë automatike AK-47, me qëllimin të vras të gjithë personat brenda automjetit. Mbrojtja pohon se përshkrimi i bëra nga gjykata si në vijim “ata u përpoqën të vrasin policin vendor B M (SHPK) dhe përkthyesin R Z (UNMIK), të cilët i shpëtuan sulmit, në atë kohë të dy persona zyrtar të cilët ishin duke kryer detyrat e tyre për sigurinë publike dhe sundimin e ligjit”, është në kundërshtim me ligjin pasi që statusi i një përkthyesi nuk është një



personi zyrtar i parashikuara me ligji. Arsyetimi se përkthyesi është një punonjës sigurimi është tërësisht kundërtshënës.

Në mënyrë që të jetë në gjendje për t'u përgjigjur pretendimeve të kërkuarit, Gjykata Supreme e Kosovës duhet fillimisht të shqyrtojë nëse statusi i një përkthyesi i ka plotësuar kushtet ligjore të një personi zyrtar siç përcaktohet në ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se KPPK e definon statusin e personit zyrtar. Neni 107 thotë:

(1) Shprehja "person zyrtar" do të thotë:


- 1) Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik;
- 2) Personi i autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit a ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin ushtron autoritet publik dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme;
- 3) ...
- 4) Personi i cili është anëtar i personelit të UNMIK-ut ose i KFOR-it pa cenuar imunitetin dhe privilegjet e zbatueshme që i janë dhënë atij personi;
- 5) ...
- 6) Personi në një organizatë publike ndërkombëtare ose mbi nacionale i cili njihet si zyrtar ose punonjës tjetër i kontraktuar sipas rregulloreve të personelit të organizatës së tillë;

Ky kolegji, me respekt, nuk pajtohet me avokatin mbrojtës se në bazë të ligjit vetëm policët mund të konsiderohen të kenë statusin e personit zyrtar në ofrimin e sigurisë.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se është e parëndësishme grada dhe/ ose pozicioni i personit në një organizatë për qëllim të përcaktimit të statusit zyrtar të një personi. Të gjitha organizatat përfshirë edhe forcat e policisë kanë një strukturë menaxhimi që përcakton marrëdhëniet ndërmjet funksioneve dhe pozita, dhe ndan dhe delegon rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për të kryer detyrat e përcaktuara, etj.

Për sa kohë që dikush mban një zyrë dhe / ose funksion ligjor apo mandat, në një organizatë apo qeveri dhe merr pjesë në ushtrimin e autoritetit që i është besuar atij ose asaj, ky person konsiderohet si një person zyrtar.

Në lëndën në fjalë, shihet qartë se përkthyesi nuk ka qenë rastësisht në vendin e ngjarjes. Përkundrazi në ditën kritike ai ishte caktuar për të ndihmuar ekipin e përzier të përbërë nga



policë ndërkombëtare dhe vendorë. Pa asnjë dyshim, përkthyesi ishte i punësuar nga UNMIK-u dhe ishte anëtar zyrtar i kësaj organizate.

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar mbetet pa gabime për sa i përket pretendimit të ngritur nga avokati mbrojtës.

5. Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë avokati mbrojtës i referohet pjesës së aktgjykimit (faqe 36) që merret me çështje të pusisë të planifikuar gjoja kundër automjetit të Policisë së UNMIK-ut. Avokati mbrojtës pohon se gjykata e apelit gabimisht ka miratuar pikëpamjen e gjykatës së shkallës së parë, kur ka paraqitur që prita e bërë nga i pandehuri është provuar bazuar në dëshmitë e R. Z. dhe B. M., të cilët sipas gjykatës së shkallës së parë dhanë dëshmi të cilat përputhen. Avokati mbrojtës pohon se në faqen 45 të aktgjykimit të shkallës së parë është theksuar në mënyrë specifike 'mund të ndodhë që ishte planifikuar një pritë kundër Policisë së UNMIK-ut, por edhe kjo nuk mund të konstatohet përtej dyshimit të arsyeshëm', e cila padyshim është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit të lëshuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se pretendimet e tilla janë të lidhura drejtpërdrejt me vërtetimin e gjendjes faktike, arsye për të cilën kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet nën dispozitat e KPPPK-së.

Neni përkatës 451 (2) thotë:

(2) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ...

Më tej, neni 456 i KPPPK thotë:

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (nenet 405 dhe 451, paragrafi 2 i këtij Kodi).

Nuk është detyrë e Gjykatës Supreme të Kosovës për të vlerësuar situatën faktike të vërtetuar në shkallët e mëparshme në këtë fazë të procedurës, përveç nëse ka prova të reja të sigurta që tregojnë se vendimet e tilla janë dhënë qartazi në mënyrë të padrejtë dhe të pasaktë. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se avokati mbrojtës nuk ka deklaruar asnjë faktë tjetër të ri, por ato të cilat janë adresuar dhe trajtuar drejt në shkallët e mëparshme.

Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në këtë pjesë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë bie jashtë mundësisë të rishqyrtimit në këtë fazë të procedurës. Prandaj, në këtë pjesë ajo është refuzuar si e papranueshme.



6. Mbrojtësi argumenton se gjetjet e gjykatës së apelit se gjykimi i mbajtur në burgun e Dubravës ka qenë i rregullt janë të gabuara dhe në kundërshtim me raportet e organizatave serioze sikurse është OSBE, etj. Avokati mbrojtës pohon se gjetjet e aktgjyqimit të kundërshtuar që përmban se ' këto masa nuk ishin të asaj natyre që të mund të pengojnë ose kufizojnë të drejtën e ushtrimit të plotë të mbrojtjes', nuk qëndrojnë. Avokati mbrojtës më tej pohon se gjykata nuk e ka përjashtuar publikun nga një pjesë e seancës në dëm të të pandehurit në këtë mënyrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale.


Në adresimin e kësaj pike Gjykata Supreme e Kosovës i referohet vendimit të datës 09 qershor 2006 të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSPKB), që miratoi ndërrimin e vendit për të kryer procedurat e gjyqimit në burgun e Dubravës. Sikurse është treguar nga gjykata në shkallët e tjera, me të cilat ky kolegji pajtohet plotësisht, pa dyshim PSSP-ja ka qenë autoritet i duhur për një miratim të tillë sipas Rregullores së UNMIK-ut 1 / 1999 neni 1.

Bazuar në dokumentacionin e shkresave të lëndës, sipas ligjit në fuqi në këtë lëndë nuk janë vërejtur shkelje të drejtave të mbrojtjes të garantuara për të pandehurin. Ky kolegji konstaton se procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat e procedurës në respektim të plotë të drejtave të të pandehurit.

Është evidente se procedurat e gjyqimit janë shtyrë, pasi trupi gjykues kishte mësuar nga shefi i Sigurimit se rrethanat e sigurisë për shkak të mungesës së hapësirës në të ashtuquajturën sallë e gjykatës nuk kanë lejuar heqjen e prangave të të akuzuarit gjatë seancës. Kolegji vendosi të shtyjë shqyrtimin gjyqësor deri sa u zbatuan masat e nevojshme të cilat lejuan heqjen e prangave. Kjo tregon respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut nga ana e trupit gjykues të paraparë në instrumentet e ndryshme ndërkombëtare, veçanërisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se trupi gjykues ka vepruar në pajtim me ligjin. Çështjen nëse vendi në të cilin gjykimi u zhvillua ka plotësuar të gjitha standardet për një gjykim të drejtë, kolegji konstaton se çështja shkon përtej procedurës penale të ndjekur, si rrjedhojë jashtë hapësirës së shqyrtimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Sa i përket pjesës së dytë të pyetjes që ka të bëjë me përjashtimin e publikut, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se, është rregull që procedura e gjyqimit të jetë publike. Mosrespektimi i rregullës së tillë përbën një shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe po ashtu shkelje të instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare. Largimi i publikut është një përjashtim i cili zbatohet vetëm kur parashikohet në mënyrë specifike me ligj. Neni 329 i KPPPK-së në mënyrë specifike rendit rastet kur publiku mund të përjashtohet nga i tërë apo nga një pjesë e shqyrtimit kryesor. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykata e shkallës së parë kishte vendosur në mënyrë të drejtë për refuzimin e kërkesës së avokatit mbrojtës për përjashtimin e



publikut. Asnjë nga kriteret për përjashtim të pjesëshëm dhe / ose të plotë të publikut nga shqyrtimi kryesor nuk janë përmbushur në kërkesën e mbrojtësit.

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron këtë pikë si të pabazuar.

7. Avokati mbrojtës pohon se përbërja e trupit gjykues nuk ishte në pajtim me ligjin. Mbrojtja argumenton se i pandehuri Sh M ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues para fillimit të shqyrtimit kryesor dhe se kërkesa nuk është trajtuar në procedurë të rregullt. Po ashtu kishte kërkesë për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, z. Anton Nokaj, prandaj në emër të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në lidhje me kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues ka vendosur zëvendësi i kryetarit një gjyqtar i asaj gjykate. Avokati mbrojtës pohon se KPPPK-së nuk njeht ndonjë zëvendës-kryetar të gjykatës dhe një personi të tillë nuk ia atribuon ndonjë autorizim në këtë kuptim. Zëvendësi nuk mund të vendosë asnjëherë në lidhje me përjashtimin e Kryetarit. Me ligj bindshëm dhe saktësisht është e përcaktuar kush vendos në lidhje me përjashtimin. Kryetari i Gjykatës së Qarkut ishte përjashtuar dhe askush nuk mund të vendosë në vend të tij.


Gjykata Supreme e Kosovës vëren se avokati mbrojtës në mënyrë jo të drejtë argumenton se kërkesa për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës është vendosur nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.

Sikurse është treguar në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së dytë dhe të tretë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës vendosi mbi një kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me mbrojtësin që një zëvendës i cili ishte duke zëvendësuar Kryetarin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nuk kishte autorizim për të vendosur mbi kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues. Ky kolegji konstaton se gjykatat kanë vendosur saktë që në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut, personi që e zëvendëson atë kishte autoritet dhe përgjegjësi për të ushtruar funksionet që mundësojnë një zhvillim të duhur të aktiviteteve në kuadër të një gjykate.

Prandaj Gjykata Supreme këtë pikë e konsideron si të pabazuar.

8. Avokati mbrojtës argumenton se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme pasi që përgjimet telefonike-respektivisht masat e fshehta në tërësi ishin kryer në mënyrë të paligjshme. Avokati mbrojtës përfshin duke i referuar argumentet e paraqitura nga ankesat në shkallët e mëparshme si pjesë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Për pikën e veçantë të mësipërme, për Gjykatën Supreme të Kosovës mjafton të deklaroj se avokati mbrojtës vetëm në përgjithësi argumenton se prova ishte marrë në mënyrë të paligjshme. Prandaj konkluzionet e shkallëve të mëparshme se provat janë marrë në mënyrë të duhur, administruar dhe vlerësuar nga gjykata janë me vend dhe të njëjtën e ndan edhe Gjykata Supreme e Kosovës.



9. Avokati mbrojtës pretendon se radiolidhja, Motorola, edhe po që se do të kishte provë e cila tregon se radioja i kishte takuar pikërisht ish policit të SHPK-së z. Sh M dhe ende ka provë në shkresat e lëndës e cila provon se Motorola nuk ishte në posedim të Sh M në gjashtë muajt e fundit para incidentit. Avokati mbrojtës pohon se prova e tillë është në formë të shkruar dhe është pjesë e shkresave të lëndës, por gjykata ka dështuar të komentoj mbi të. Sipas avokatit mbrojtës mos shqyrtimi i kësaj prove e ka penguar të pandehurin për të rishqyrtuar atë para gjykatës duke shkelur të drejtat e tij.

Në trajtimin e kësaj pike, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e avokatit mbrojtës janë të lidhura drejtpërdrejt me vërtetimin e gjendjes faktike, bazë për të cilën kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet nën dispozitat e KPPPK-së. Prandaj, në këtë pjesë ajo është e refuzuar si e papranueshme.

10. Mbrojtja më tej argumenton se përgjimi i bisedës telefonike mes të klientit dhe avokatit ishte i paligjshëm dhe se prova e tilla nuk mund të përdoret si provë nga gjykata. Kështu avokati mbrojtës pohon se gjykata duhet të ketë vendosur për këtë provë si të papranueshme dhe të ndante atë nga shkresat e lëndës. Sipas avokatit mbrojtës, nuk është e parëndësishme, se avokati nuk ishte mbrojtësi i të pandehurit Sh M . Avokati i përgjuar ishte mbrojtës në këtë çështje dhe interesat ligjore të pandehurit Sh M dhe të klientit të cilin e përfaqësonte ai avokat ishin të njëjta.

Gjykata Supreme e Kosovës, me respekt, nuk pajtohet me avokatin mbrojtës se përgjimi i të pandehurit derisa i pandehuri Sh M ishte duke komunikuar me një avokat tjetër e jo me avokatin e tij ishte i paligjshëm. Ky kolegji pajtohet me gjykatën e shkallës së tretë se të jesh avokat nuk nënkupton të jesh i përjashtuar nga përgjimet telefonike. Sikurse është thënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, me të cilën ky kolegji pajtohet plotësisht, përjashtimi nga rregulli është menduar për ta mbrojtur atë lidhje të veçantë i pandehur/avokat dhe jo për të shërbyer për interesat e përbashkët të palëve. Koncepti i interesave të përbashkëta të pandehurve në një çështje penale është shumë relativ. Mund të jetë që të pandehurit të ndajnë të njëjtat interesa ashtu si është e mundur se interesat e tyre janë diametralisht të ndryshme edhe pse sërish janë bashkë-të pandehurë në një çështje penale. Gjykata Supreme i është referuar jurisprudencës të KEDNJ. Prandaj ky kolegji konsideron se kjo pikë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazë.



B. ZBATIMI I GABUAR I KODIT PENALE TË KOSOVËS

11. Avokati mbrojtës argumenton se gjykata e shkallës së parë me vërtetim të pamjaftueshëm dhe të gabuar të fakteve ka ardh në përfundim të gabuar se i akuzuari Shf M ka kryer veprën penale për të cilën ai përfundimisht u shpall fajtor me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës i cili me këtë kërkesë është kundërshtuar. Si pasojë avokati mbrojtës pohon se vendimi për dënim nuk është i ligjshëm pasi që i pandehuri nuk është fajtor.

Sa i përket kontestimit në lidhje me ekzistencën e fakteve vendimtare në të cilat mbështeten gjykatat, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se është e rëndësishme për të përsëritur sërish se kontestimi i aktgjyqimeve në këtë fazë të procedurës në bazë të gjendjes faktike është i papranueshëm në pajtim me nenin 451 (2) të KPPPK. Avokati mbrojtës në përgjithësi argumenton vlerësimin jo të drejtë dhe jo të plotë të provave. Pretendimet e tilla janë adresuar dhe trajtuar tashmë siç duhet gjatë procedurës të apelit. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk ka asgjë të re nga pohimet e mëparshme të ngritura nga avokati mbrojtës që do të dobësonin bazën e përgjithshme faktike të akuzave.

Prandaj ky kolegji mendon se çdo përpunim i mëtejshëm mbi këtë pikë është i panevojshëm dhe do të ishte i tepërt.

12. Në fundi avokati mbrojtës pohon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës i cili ishte kundërshtuar me ankesë, gjykata e shkallës së dytë kishte ndryshuar kualifikimin ligjor të veprave. Gjykata e shkallës së dytë ndryshe nga gjykata e shkallës së parë ka shpallur të pandehurin fajtor për vepër penale sipas nenit 30, paragrafi 2, pika 2 të LPK në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së. Kjo do të thotë, sipas avokatit mbrojtës, se gjykata tërhoqi rrethanën rënduese nga pika 6 e LPK. Megjithatë rrethana e tilla lehtësuese nuk është pasqyruar në lartësinë (uljen) e dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, me respekt, nuk pajtohet me pikëpamjen e avokatit mbrojtës në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit. Kjo lëndë është veçanarisht e rëndë dhe kërkoi një dënim të rëndë. Sa i përket llojit dhe kohëzgjatjes të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se nuk ka asnjë detyrim për gjykatën për të reduktuar dënimin për shkak të lirimit të pjesëshëm dhe / ose modifikimit. Gjykata është e lidhur vetëm me maksimumin e dënimit.

Në të vërtetë, gjykata e shkallës së dytë ka shpallur të pandehurin fajtor për vepër penale sipas nenit 30, paragrafi 2, pika 2 të LPK në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së. Ndryshimi i aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me paragrafin 6 nuk e ndryshon formën e kualifikuar të veprës penale sikurse parashikohet me ligj. Duke marrë parasysh rrethanat në lidhje me lëndën, mënyrën në të cilën është kryer krimi - *modus operandi*, si dhe intensitetin e

rrezikut shoqërore të veprës penale, kjo gjykatë nxjerr përfundimin se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pra në përputhje me qëllimin e dënimit, siç parashihet me ligj. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së dytë dhe të tretë ka shqyrtuar plotësisht dhe drejtë të gjitha rrethanat përkatëse, kur ka shqiptuar llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit.

III. Konkluzioni i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e lartë përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës përfundon se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi av Teki BOKSHI në emër të pandehurit Sh M , kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P nr. 2003/2005 i datës 09 nëntor 2005, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap 190/2009, i datës 27 janar 2010 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, API 01/2010 i datës 26 nëntor 2010, është e pabazuar.

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ 36/11, data 05 korrik 2011

Kryetari i kolegjit:

Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësi:

Adnan Isufi
Këshilltar Ligjor


Anëtarët e kolegjit:

Gerrit Marc-Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Charles L Smith III
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Kaciku
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Valdete Daka,
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POŠTOM

Funëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Mjeti Juridik: Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. (neni 45 L paragrafi (2) i KPPK).